



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1658/7 prot

Datë 03.07.2025

V E N D I M

Nr. 846/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.07.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për ankesën e operatorit ekonomik “O.E.S DISTRIMED” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-49809-06-02-2025, me objekt: “Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale”, me fond limit 1,775,812.30 *(një milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e dymbëdhjetë pikë tre)* lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Mat.

Ankimues:

Operatori ekonomik “O.E.S DISTRIMED” SHPK me NIPT K31520054N me adresë Blv: “Bajram Curri”, pallati “Kastrati”, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Shërbimit Spitalor Mat, me adresë: Lagjja “Drita”, KP 8001, Burrel.

Subjekte të Interesuara:

Operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK me NIPT L41629009A dhe adresë, Mëzez Rruga “Gani Domi”, pallati nr.1, shkalla 3, kati 1, apartament 46, Zonë kadastrale nr. 8180, numër pasurie 2/16+4-46, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 03-06-2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-49809-06-02-2025, me objekt: “Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale”, me fond limit 1,775,812.30 **(një milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e dymbëdhjetë pikë tre)** lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Mat.

II.2. Në datën 13-06-2025, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 19.06.2025 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar si më poshtë:

1. “CARPATHIA ALBANIA” SHPK	1,490,000	lekë pa tvsh kualifikuar
2. “O.E.S DISTRIMED” SHPK	1,771,981	lekë pa tvsh kualifikuar

II.4. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton, se më datë 20.06.2025 është publikuar njoftimi i fituesit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në datën 25.06.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1658/2025 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5473 e operatorit ekonomik “O.E.S DISTRIMED” shpk për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-49809-06-02-2025, me objekt: “Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale”, me fond limit 1,775,812.30 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Mat.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 1658/1 prot., datë 26.06.2025 duke publikuar kriteret për të cilat ngrihen pretendime nga operatori ekonomik ankimes për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” shpk.

II.7. Me shkresën me nr. 786/4 prot., datë 30.06.2025 dorëzuar nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, protokolluar me tonën me nr. 1658/2 prot., datë 30.06.2025, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendim nr. 786/3 prot, datë 30.06.2025 i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “O.E.S Distrimed” shpk, për

procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimi i ankesës. Konkretisht, autoriteti kontraktor në vendimin e sipërcituar ka arsyetuar si më poshtë:

“[...] Në zbatim të dispozitave ligjore të parashikuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, DST-së si dhe dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi. Personi përgjegjës për shqyrtimin e ankesës gjykon se:

Ka mospërputhje ndërmjet mostrave të dorëzuara edhe dokumentit të ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik “Carpathia” SHPK në lidhje me origjinën e mallit. Operatori ka ngarkuar në sistem një dokument ku thuhet se të gjitha mostrat janë me origjinë nga Kina, ndërkohë disa nga mostrat kanë origjinë ndryshe (jo nga Kina) të stampuar në paketim.

Në kuadër të frymës së transparencës në legjislacionin e prokurimit publik dhe akteve nënligjore për zbatimin e tij, personi përgjegjës për shqyrtimin e ankesës në respekt të detyrimeve që burojnë nga dispozitat e ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar:

VENDOSI:

- 1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “O.E.S Distrimed” për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar mallra”, Nr. REF-49809-06-02-2025 me objekt “Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale”, me fond limit 1,775,812.3 (një milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e dymbëdhjetë pikë tre) lekë pa Tvsh.*
 - 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet Komisionit të Prokurimit Publik dhe ankimuesit “O.E.S Distrimed” sh.p.k dhe operatorëve të tjerë të interesuar.*
- [..]*

II.8. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton se në datë 01.07.2025 protokolluar me nr. 1658/3 prot., janë dorëzuar argumente nga operatori ekonomik i interesuar “Carpathia Albania” SHPK të cilat nuk janë dorëzuar brenda afateve dhe formën e parashikuar në nenin 113 të LPP-së.

II.9 Me shkresën me nr. 786/4 prot., datë 30.06.2025 protokolluar me tonën me nr. 1658/2 prot., datë 30.06.2025, është ridërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendim nr. 786/3 prot., datë 30.06.2025 i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “O.E.S Distrimed” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimi i ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “O.E.S Distrimed” shpk, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Carpathia Albania” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Me shkresën me nr. 786/4 prot., datë 30.06.2025 dorëzuar nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, protokolluar me tonën me nr. 1658/2 prot., datë 30.06.2025, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendim nr. 786/3 prot, datë 30.06.2025 i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “O.E.S Distrimed” shpk, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimi i ankesës. Konkretisht, autoriteti kontraktor në vendimin e sipërcituar ka arsyetuar si më poshtë:

“[...] Në zbatim të dispozitave ligjore të parashikuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, DST-së si dhe dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi. Personi përgjegjës për shqyrtimin e ankesës gjykon se:

Ka mospërputhje ndërmjet mostrave të dorëzuara edhe dokumentit të ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik “Carpathia” SHPK në lidhje me origjinën e mallit. Operatori ka ngarkuar në sistem një dokument ku thuhet se të gjitha mostrat janë me origjinë nga Kina, ndërkohë disa nga mostrat kanë origjinë ndryshe (jo nga Kina) të stampuar në paketim.

Në kuadër të frymës së transparencës në legjislacionin e prokurimit publik dhe akteve nënligjore për zbatimin e tij, personi përgjegjës për shqyrtimin e ankesës në respekt të detyrimeve që burojnë nga dispozitat e ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar:

VENDOSI:

3. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “O.E.S Distrimed” për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar mallra”, Nr. REF-49809-06-02-2025 me objekt “Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale”, me fond limit 1,775,812.3 (një milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e dymbëdhjetë pikë tre) lekë pa Tvsh.
 4. Kopje ekëtij vendimi i dërgohet Komisionit të Prokurimit Publik dhe ankimuesit “O.E.S Distrimed” sh.p.k dhe operatorëve të tjerë të interesuar.
- [..]

III.1.2. Neni 30 i LPP, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera”.

III.1.3 Neni 113 I LPP-së, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: “1. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. **Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor për paraqitjen e këtyre argumenteve është 7 ditë nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 5 ditë. Paraqitja e argumenteve bëhet në Sistemin e Ankesave Elektronike.** 2. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë në lidhje me ankesën për këtë procedurë prokurimi”

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar i cili parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

III.1.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se pas vendimit nr. 786/3 prot., datë 30.06.2025 të Komisionit të Shqyrtimit të ankesës, gjendja juridike dhe faktike e operatorit ekonomik “Carpathia Albania” shpk do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura e prokurimit objekt ankimi., rrjedhimisht pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues “O.E.S Distrimed” shpk, nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Gjithashtu referuar materialeve të fashikullit administrativ rezulton se operatori ekonomik “Carpathia Albania” shpk si subjekt i interesuar me shkresën me lëndë “Përgjigje ndaj ankesës së paraqitur në procedurën e prokurimit me titull “Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale”, nr. reference REF-49809-06-02-2025, mbrojtje e vlefshmërisë së ofertës sonë dhe kërkesës për rrëzim të pretendimeve të pabazuara”, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1658/3, datë 01.07.2025 ka paraqitur argumente pranë KPP-së dorëzuar nëpërmjet shërbimit postar. Nga shqyrtimi i argumenteve protokolluar me nr. 1658/3 prot., Komisioni konstaton se argumentet nuk janë dorëzuar në përputhje me nenin 113 të LPP-së. Komisioni konstaton, se subjekti i interesuar “Carpathia Albania” shpk nuk ka respektuar afatet, si dhe kushtet formale për paraqitjen e argumenteve në përputhje me nenin 113 i LPP-së ku parashikohet shprehimisht se: “1. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. **Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor për paraqitjen e këtyre argumenteve është 7 ditë nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 5 ditë. Paraqitja e argumenteve bëhet në Sistemin e Ankesave Elektronike**”. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “O.E.S Distrimed” shpk për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-49809-06-02-2025, me objekt: “Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale”, me fond limit 1,775,812.30 *(një milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e dymbëdhjetë pikë tre)* lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Mat.
 2. Autoriteti kontraktor të zbatojë vendimin sipas konstatimeve të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “O.E.S Distrimed” shpk.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

